



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
**OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA**

C.nr.241/12

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e BAZUAR dhe

II. **VËRTETOHET** se paditësi: nga  
është pronar në bazë të mbajtjes me mirëbesim për më tepër se 20 vite i sipërfaqes prej 180 m<sup>2</sup>, pjesë e ngastrës kadastrale nr. ZK ,

III. **OBLIGOHET** i paditurit që të drejtën e specifikuar në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njehin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojë regjistrimin e kësaj të drejtë në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.

IV. **OBLIGOHET** paditësi që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestuese, përfaqësuesit te përkohshëm t'ia paguaj shumën 135 euro në afat 15 ditësh nën kërcënimin e përbartimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditësi me anë të padisë dhe në deklarimet e të autorizuarit të saj  
në seancë gjyqësore kerkoi nga gjykata që t vërteton se paditësja është  
pronare mbi bazën e shitblérjes dhe mbajtjes me mirëbesim për më tepër  
se 20 vite i paluajtshmërisë pjesë e ngastrës ZK në

Meqenëse të paditurve nuk i dihej vendbanimi, gjykata duke vepruar  
konform propozimit të të autorizuarit të paditëses e pas shterjes së  
mjeteve rrëth sigurimit të adresës eventuale të të paditurit, të njëjtit ia ka  
caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të parë në seancë kryesore dhe  
në fjalën përfundimtare deklaroit se e kundërshtoi padinë dhe  
kérkesëpadinë, i propozoj gjykatës që mbi bazën e provave të  
administruara të bien vendim meritor. Shpenzimet e procedurës i kerkoi.

Në fjalë përfundimtare i autorizuari i paditëse deklaroit se mbetet pranë  
padisë dhe kérkesëpadisë si dhe precizimit të së njëjtës, me shkrim ku  
kérkoi që gjykata të vërtetë se paditësi eshtë pronar i  
sipërfaqes prej 180 m<sup>2</sup> pjesë e ngastrës kadastrale ZK në  
shpenzimet e procedurës nuk i kerkoi.

Në seancë kryesore gjykata dëgjoi dëshmitarët:  
dhe

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykata  
administroi këto prova: ekspertiza gjeodete e dt. 19.06.2014, certifikata e  
pronësisë me nr. të njësisë ) e dt. Së lëshimit  
28.08.2014, kopja e planit të parcelës kontestuese, procesverbali i daljes  
në vend, kérkesa për regjistrim e vdekjes.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha  
së bashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto  
përfundime:

Nuk është kontestuese se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese e  
ka në posedim, pasi këtë fakt gjykata e vërtetoi në momentin e daljes në  
teren, e po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekspertiza gjeodete.

Nuk është kontestuese se ngastra ) është evidentohet në  
emër të të paditurit, ky fakt vërtetohet në bazë të certifikatës së  
pronësisë.

Sa i përket çështjes së shitblérjes dhë periudhës së mbajtjes, e po ashtu  
edhe mirëbesimit në mbajtje, në mungesë të provave tjera për të  
dëshmuan këtë fakt gjykata u bazuë në deklarimin e dëshmitarëve, të  
cilët deklaratat e tyre ia dhanë nën betim.



Dëshmitari *[redacted]* i deklaroi se babi i *[redacted]*, e ka blerë shtëpinë e cila në luftë i është djegur dhe kjo shitblerje është bere para shume viteve, mirëpo nuk me kujtohet për shkak te gjendjes shëndetësore dhe moshës, shtëpia ka pasur pak oborr të rrrethuar, familjen e paditësit askush nuk e ka penguar në shfrytëzimin e saj.

Dëshmitari *[redacted]* deklaroi se dhëndëri i tij *[redacted]*, babi i paditësit rrreth viteve 1960-1962 e ka blerë shtëpinë me oborr nga *[redacted]*, i cili ka qene *[redacted]* pasi e ka ble reshte vendosur në shtëpi ndërsa në pjese e oborrit prapa shtëpisë e ka ndërtuar një shtëpi, te njëtin askush nuk e ka penguar ne shfrytëzim. Shtëpia me oborr ka qene ne një gjatësi përafërsisht 25 metra ndërsa gjerësia rrreth 10-15 metra, koj është e vërtet rrreth këtij rasti.

Ndërsa dëshmitari *[redacted]* deklaroi se *[redacted]*, babi i paditësit e ka blerë shtëpinë dhe dugajen rrreth viteve 1962-1964 aty ka qene një shtëpi jo shume e madhe dhe një dugaj, pasi e ka blerë *[redacted]* e ka zgjeruar dhe e ka ndërtuar një shtëpi dy kateshe ku është vendosur dhe askush nuk i ka penguar asnjë here ku aty i kanë lindur fëmijët

Dy dëshmitaret *[redacted]* i dhe *[redacted]* nuk janë në lidhje familjare me paditësen, ndërsa dëshmitari *[redacted]* është ne gjini krushqie me paditësin, të njëjtit në deklaratat e tyre ishin të sinqertë, dhë ishin në moshë të shtyre.

Deklaratat e këtyre dëshmitarëve rrreth blerjes se truallit dhe ndërtimit të shtëpisë po ashtu përputhen edhe me faktin se me rastin e daljes në teren gjykata konstatoi tok pjellore, disa shtëpi për rrreth.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, 28 të këtij Ligji. Mirëpo kjo e drejtë parashihet dhe me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe Të Drejtat Tjera Sendore.

Arsyeja e aplikimit të Ligjit të mëhershëm qëndron në faktin se baza juridike e kërkesëpadisë është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky ligj.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjygjëse nuk i kërkuau shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.241/2012 Datë: 23.12.2014**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

*EXP: Pej. f. fe Pekolli f. p. 4744*